

Bachelor i Ri

në “MENAXHIM BIZNESI”

Program Bachelor në "Menaxhim Biznesi"

Programi Bachelor në “Menaxhim Biznesi” me dy profile, “Menaxhim Agrobiznesi” dhe “Menaxhim i Turizmit Rural” mundëson ndërtimin e kompetencave që lidhen me menaxhimin e agrobiznesve duke përfshirë operatorët e agrobiznesit si edhe të njësive ekonomike që janë përfshirë në sektorin e turizmit rural. Specializimi në profilin **Menaxhim i Agrobiznesit** përgatit studentët të drejtojnë operatorët e zinxhirit të vlerës të produkteve ushqimore, duke zbatuar drejtpërdrejt disiplinat kryesore të biznesit—financë, marketing dhe planifikim strategjik. Ndërsa, profili **Menaxhim i Turizmit Rural** ndërthur parimet e turizmit rural me mjetet themelore të menaxhimit, duke i pajisur të diplomuarit me njohuri mbi parimet e menaxhimit me qëllim që të projektojnë, zhvillojnë dhe administrojnë produkte e shërbime turistike që gjallërojnë ekonominë rurale.

Objektivat e Programit

Ky program synon të:

- Të ofrojë një formim cilësor akademik dhe praktik në fushën e menaxhimit të agrobiznesit dhe menaxhimit të bizneseve të turizmit rural.
- Të formojë menaxherë të aftë për të drejtuar dhe udhëhequr me sukses fermat, njësitë turistike dhe bizneset përgjatë gjithë zinxhirit të prodhimit, përpunimit dhe marketingut të ushqimit.
- Të pajisë studentët me kompetenca të menaxhimit, sipërmarrjes dhe lidërshit, e të promovojë praktika të qëndrueshme menaxheriale duke integruar inovacionin teknologjik, në mënyrë që studentët të bëhen kontribues aktivë në rritjen dhe transformimin e ekonomisë.

Kompetencat Kryesore

Të diplomuarit në këtë program studimi, do të fitojnë:

- Njohuri profesionale të avancuara në menaxhimin e fermës dhe agrobizneseve: Studentët formohen në parimet e menaxhimit, teknikat e marketingut dhe teknologjinë e prodhimit.

- Aftësi në vlerësimin dhe analizën e performancës së fermës/agrobiznesit: Përmes monitorimit të rregullt të performancës financiare, teknike dhe organizative.
- Aftësi në marketingun dhe shitjen e produkteve ushqimore: Studentët aftësohen të zhvillojnë plane marketingu dhe strategji shitjeje që i përgjigjen kërkesave të tregut vendas dhe ndërkombëtar.
- Aftësi për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit: Programi u jep studentëve njohuri mbi metodat e kërkimit dhe analizës së të dhënave.
- Njohuri mbi institucionet financiare dhe publike me fokus në sistemin ushqimor: Programi përfshin njohuri mbi funksionimin e institucioneve financiare, kompanive të sigurimit, organizatave ndërmjetëse, skemave të financimit dhe mbështetjes.
- Aftësi për të menaxhuar bizneset e turizmit rural bazuar në të gjitha parimet e funksioneve të menaxhimit, të bizneseve të shërbimeve turistike.
- Njohuri mbi parimet e mikpritjes dhe shërbimit ndaj klientit për të rritur kënaqësinë e konsumatorit turistik.
- Aftësi për të promovuar destinacionet e turizmit rural nëpërmjet komunikimit efektiv, marketingut dhe certifikimit.
- Përgatitje në planifikimin, buxhetimin dhe zbatimin e projekteve e eventeve të lidhura me turizmin.
- Njohuri shumë të mira mbi prodhimin dhe përpunimin bujqësor që zhvillohet në aktivitetet ekonomike në zonat rurale si ferma, agrobiznese, njësitë e agroturizmit dhe turizmit rural.
- Aftësi ndërpersonale dhe komunikimi: Studentët fitojnë aftësi bashkëpunimi, negociimi dhe lidhshëm, si dhe komunikim profesional me aktorët e ndryshëm të zinxhirit ushqimor, institucionet publike dhe komunitetin rural.

Mundësitë e Karrierës

Të diplomuarit mund të ndjekin karrierën e tyre në pozicione të ndryshme të një sërë institucionesh dhe organizatash si:

- Institucione publike në nivel qendror apo lokal dhe agjensi zhvillimore lokale. Role të mundshme: analist politikash, specialist buxheti, ekonomist, ekspert i shërbimeve këshilluese, ekspert i politikave të turizmit, asistent i zyrtarëve publikë në hartimin e politikave.
- Në njësi agrobiznesi dhe turizmi rural: Role të mundshme: sipërmarrës në aktivitetet e turizmit rural dhe agrobiznesit, operator tregu / operator turistik / menaxher agjensie

turistike si edhe menaxher / këshilltar i agrobiznesit, administrator dhe këshilltar ferme, administrator i bizneseve të turizmit rural.

- OJF-të, think-tank-et dhe institutet kërkimore. Role të mundshme: asistent kërkimi, analist të dhënash, këshillues.
- Organizatat lokale dhe agjensi promovuese. Role të mundshme: Konsulent privat për bizneset turistike, konsulent i agjencive vendore të promovimit (me fokus në turizmin rural dhe agroturizmin)

Struktura e programit

Viti i parë i studimit përfshin në kurrikul lëndët bazë të zgjedhura me qëllim ndërtimin e të një themeli të fortë të njohurive. Përmes kurseve si “Makroekonomia”, “Mikroekonomia”, “Matematika” dhe “Matematika Ekonomike”, “Statistika” dhe “Marketingu” studentët fitojnë njohuri të domosdoshme për kuptimin e strukturave ekonomike dhe financiare. Gjithashtu, zhvillimi i aftësive komunikuese dhe prezantuese nëpërmjet moduleve “Komunikim biznesi dhe anglishte biznesi” & “Shkrim Akademik dhe Anglisht” si edhe njohuritë e fituara përmes lëndës të së drejtës janë thelbësore për suksesin profesional, duke krijuar një bazë të mirë për lidhjet akademike dhe profesionale të mëtejshme. Lëndët si “Bazat e prodhimit bimor” dhe “Bazat e prodhimit shtazor” krijojnë mundësi për marrjen e njohurive shtesë që lidhen me fushën ku operojnë bizneset bujqësore duke plotësuar njohuritë e studentëve me veçoritë e aktivitetit bujqësor.

Në vitin e dytë, programi fokusohet në përforcimin e bazave teorike dhe zhvillimin e aftësive analitike të nevojshme për interpretimin e mjedisit ekonomik dhe organizativ. Ky semestër sjell njohuri të fokusuar në menaxhim përmes lëndëve si “Menaxhimi i fermave”, “Menaxhim Agrobiznesi”, “Menaxhim Turizmi”, “Menaxhim i Burimeve Njerëzore” dhe “Menaxhimi i Biznesit të Vogël”. Këto lëndë kombinohen me lëndë formuese si “Informatikë”, “Financë”, “Kontabilitet” “Statistikë Biznesi” dhe “Marketingu Agrorishqimor” për të ofruar analizë të thelluar të çështjeve praktike dhe strategjike në mjedisin e biznesit. Për më tepër, përdorimi i sistemeve informative në biznes i ofron studentëve mjete moderne për vendimmarrje të bazuar në të dhëna. Në këtë vit refletohen edhe lëndë specifike për turizmin rural që janë Bazat e Turizmit dhe Menaxhim Turizmi. Lëndët si Menaxhimi i tokës dhe ujit apo Vlerësimi mjedisor dhe analiza e rriskut sjellin mundësitë për rritje të ndërdisiplinartit në këtë vit dhe kontekstualizimit të njohurive të marra në modulet e mësipërme

Në vitin e tretë zbatohen dy profile specializimi, secili i projektuar për t’iu përgjigjur nevojave specifike të sektorëve strategjikë: agrobiznesit dhe turizmit rural. Në profilin Menaxhim i Agrobiznesit nis me një fokus të drejtpërdrejtë në ekonominë dhe financat e sektorit bujqësor. Lëndë si, Menaxhim Operacional, Administrim dhe Menaxhim Publik, Menaxhimi Financiar dhe

Menaxhimi i Riskut dhe Sigurime janë hartuar për të ofruar njohuri të specializuara që lejojnë analizën kritike të sfidave ekonomike në sektorin bujqësor në kushtet e një mjedisi sfidues ekonomik, klimatik e mjedisor. Faza e avancuar e këtij profili përfshin lëndë të orientuara drejt menaxhimit të avancuar në agrobiznes. Lëndët si “Kontabilitet i Menaxhimit”, “Analiza e Zinxhirit të Vlerës dhe Çmimet dhe Tregjet e Produkteve Bujqësore” synojnë t’i japin studentit aftësi shkencore dhe praktike për të implementuar teknika të analizës dhe vendimarrjes.

Profili menaxhim i Turizmit Rural është projektuar për të trajtuar dinamikat specifike të bizneseve të turizmit rural dhe për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm në destinacione rurale. Kurset e para, të tilla si “Turizmi Rural”, “Menaxhim i Akomodimit në Turizëm”, “Ekonomia e Turizmit” dhe “Agroturizëm” vendosin bazat për kuptimin e sfidave dhe potencialit të sektorit. Faza e avancuar e profilit thekson ndërtimin e dijeve praktike për zhvillimin e turizmit rural. Kurset përfshijnë “Menaxhim Eventesh dhe Atraksionesh Rurale”, “Gjeografia e Turizmit, Shtigjet dhe Guidat”, të cilat synojnë të nxjerrin në pah potencialin e zonave rurale për zhvillim të qëndrueshëm. Projekti përfundimtar përfaqëson një mundësi për të demonstruar aftësitë analitike dhe inovative, duke e lidhur në mënyrë të ngushtë teorinë me praktikën më të mira të menaxhimit të turizmit.

Për të dyja profilet, lëndët si Teknologji e prodhimit të produkteve ushqimore dhe Pijeve, Infrastruktura e cilësisë, apo Sistemet e Gjeoifnormacionit janë përfshirë për të krijuar një urë të fortë midis dijeve bazë dhe atyre ndërdisiplinore. Si nevojë e krijimit të njohurive integruese, në të dy profilet janë përfshirë lëndë si Shërbimi Këshillimor. Praktikës profesionale dhe kryerjes së diplomës i jepet një hapësirë e veçantë duke u paraprirë nga lëndë që ofrojnë aftësi kërkimore dhe kompetenca ndërpersonale.

Qasja Ndërdisiplinare

Për ndërtimin e këtij programi është ndjekur parimi i ndërdisiplinaritetit i cili synon integrimin e metodave dhe mjeteve analitike të disiplinave të ndryshme, duke prodhuar njohuri të reja dhe zgjidhje të problemeve komplekse e me ndikim real për sfidat ekonomike, mjedisore, sociale e teknologjike të një bote në ndryshim të shpejtë.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare (Muster Curricula), programi integron njohuri nga fushat e teknologjisë, shkencave natyrore dhe ekonomisë dhe siguron një formim gjithëpërfshirës që përgatit studentët për sfida komplekse, ku shkencat sociale përbëjnë 52% të krediteve shkencat natyrore përbëjnë 25% të krediteve dhe shkencat teknike përbëjnë 23% të krediteve.

Pse të Zgjidhni këtë Program?

Programi Bachelor në Menaxhim Biznesi me dy profile: “Menaxhim Agrobiznesi” dhe “Menaxhim i Turizmit Rural” vjen si një program me karakter thellësisht unik. Nevoja për ofrimin e një Programi Studimi në Menaxhim Biznesi me fokus agrobiznesin dhe turizmin rural lidhet ngushtë me karakteristikat dhe rëndësinë e sektorit prodhues, përpunues e eksportues të ushqimeve si edhe sektorin e shërbimeve. Ky sektor ka nevojë për kompetenca adekuate në fushën e menaxhimit për të përmirësuar ofertën tregtare dhe për të përmbushur si duhet standardet e kërkuara duke rritur kështu nivelin e konkurrueshmërisë. Kërkesa për programe të tilla rritet për shkak të disa faktorëve që meritojnë vëmendje si i. Rritje e numrit dhe shumëllojshmërisë së fermave dhe agrobizneseve. ii. Rritje e madhësisë së njësive ekonomike. iii. Ndryshimet në kërkesën konsumatore në drejtim të cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të ofruara iv. Rritja e bizneseve rurale turistike dhe e numrit të agjensive që operojnë për të hartuar, zbatuar e monitoruar politika për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe për të promovuar destinacionet rurale shqiptare.

Profili në “Menaxhim Agrobiznesi” është organizuar në module unike që synojnë të aftësojnë studentët lidhur me qasjet bashkëkohore në menaxhimin e bizneseve në përgjithësi dhe ato të përfshira në sistemin e agrobiznesit në veçanti. Në këtë kuptim, studentët e diplomuar në këtë profil studimi zotërojnë një avantazh dallues në krahasim me studentët e diplomuar në programe të menaxhimit të ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të Lartë. Ky avantazh u siguron studentëve potencialë prioritet në lidhje me punësimin në sektorin agroushqimor dhe konkurrueshmëri në sektorë të tjerë

Profili “Menaxhim i Turizmit Rural” vjen në kuadër të prioriteteve kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, duke lidhur dy shtylla kryesore të ekonomisë shqiptare: bujqësinë dhe turizmin. Nevoja për specialistë të kualifikuar në këtë fushë është e lartë, e reflektuar në politikat, strategjitë dhe programet mbështetëse, sikurse dhe në skemat kombëtare e ndërkombëtare të financimit për agroturizmin dhe turizmin rural. Ky profil është unik në Shqipëri dhe rano. Duke pasur parasysh rritjen e vullshme të turizmit në tërësi dhe agroturizmit në veçanti, ky profil ofron të diplomuar me kompetenca unike.

KURRIKULA E STUDIMEVE

PROGRAMI I CIKLIT TE PARE TE STUDIMEVE BACHELOR NE MENAXHIM BIZNESI

Viti I, Semestri I (1)

Nr.	Modulet	Kredi te ECTS	Orë mësimore			Kate goria
			Në Auditor	Studim individual	Total	
1	Matematikë	5	60	65	125	A
2	Bazat e prodhimit bimor	5	60	65	125	A
3	Mikroekonomi	5	60	65	125	B
4	Sociologji rurale	4	45	55	100	A
5	Komunikim biznesi	4	45	55	100	D
6	Anglisht biznesi I	2	30	20	50	D
7	E drejtë biznesi	4	45	55	100	A
	Totali	29	345	380	725	

Viti I, Semestri II (2)

Nr.	Modulet	Kredi te ECTS	Orë mësimore			Kate goria
			Në Auditor	Studim individual	Total	
1	Matematikë ekonomike	5	60	65	125	A
2	Menaxhimi i tokës dhe ujit	5	60	65	125	C
3	Makroekonomi	5	60	65	125	B
4	Statistikë	5	60	65	125	A
5	Shkrim akademik	4	45	55	100	A
6	Anglisht biznesi II	2	30	20	50	D
7	Bazat e marketingut	5	60	65	125	B
	Totali	31	375	400	775	

Viti II, Semestri I (3)

Nr.	Modulet	Kredi te ECTS	Orë mësimore			Kate goria
			Në Auditor	Studim individual	Total	
1	Statistikë biznesi	5	60	65	125	B
2	Financë	5	60	65	125	B
3	Menaxhimi i ndërmarrjeve të agrobiznesi	5	60	65	125	B
4	Vlerësim mjedisi dhe menaxhim rrisku	5	60	65	125	C
5	Marketing agrorshqimor	4	45	55	100	B

6	Bazat e turizmit	4	45	55	100	B
	Totali	28	330	370	700	

Viti II, Semestri II (4)

Nr.	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			Në Auditor	Studim individual	Total	
1	Bazat e prodhimit shtazor dhe akuakultures	4	45	55	100	C
2	Menaxhim i fermave	5	60	65	125	B
3	Kontabilitet	5	60	65	125	B
4	Sipërmarrja dhe drejtimi i biznesit të vogël	5	60	65	125	B
5	Menaxhim turizmi	4	45	55	100	B
6	Menaxhim i burimeve njerëzore	5	60	65	125	B
<i>Modul me Zgjedhje I</i>						
7	Informatikë e aplikuar	4	45	55	100	D
	Programim	4	45	55	100	D
	Totali	32	375	425	800	

PROFILI MENAXHIM AGROBIZNESI

Viti III, Semestri I (5)

Nr.	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			Në Auditor	Studim individual	Total	
1	Menaxhim operacional	5	60	65	125	B
2	Administrim dhe menaxhim publik	5	60	65	125	B
3	Drejtim financiar i agrobiznesit	5	60	65	125	B
4	Menaxhimi i riskut dhe sigurimet	5	60	65	125	B
5	Ekonomiksi punës	5	60	65	125	B
<i>Modul me Zgjedhje II</i>						
6	Histori e doktrine ekonomike	4	45	55	100	C
	Politikat agrourbushqimore	4	45	55	100	C
	Totali	29	345	380	725	

Viti III, Semestri II (6)						
Nr.	Modulet	Kredit e ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			Në	Studim individual/Pra ktike Profesionale	Total	
			Auditor			
1	Analiza e zinxhirit të vlerës dhe çmimet e tregjet e produkteve bujqësore	6	75	75	150	B
Modul me Zgjedhje III						
2	Teknologjitë e përpunimit agroushqimor	5	60	65	125	C
	Infrastruktura e cilësisë	5	60	65	125	C
	Menaxhimi i makinerive bujqësore	5	60	65	125	C
Modul me Zgjedhje IV						
3	Njohuri mbi informacionin	4	45	55	100	C
	Bazat e kërkimit	4	45	55	100	C
Modul me Zgjedhje V						
4	Kontabilitet drejtimi	4	45	55	100	B
	Taksim	4	45	55	100	B
	Shërbimi këshillimor	4	45	55	100	B
5	Praktike profesionale	6		150	150	D
6	Teza bachelor/ Provim përfundimtar	6	10	140	150	E
	Totali	31	235	540	775	

PROFILI MENAXHIM I TURIZMIT RURAL						
Viti III, Semestri I (5)						
Nr.	Modulet	Kredit e ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			Në Auditor	Studim individual	Total	
1	Turizmi rural	5	60	65	125	B
2	Administrim dhe menaxhim publik	5	60	65	125	B
3	Menaxhim i akomodimit në turizëm	5	60	65	125	B
4	Ekonomia e turizmit	5	60	65	125	B
5	Agroturizëm	5	60	65	125	B
<i>Modul me Zgjedhje II</i>						
6	Histori e doktrineve ekonomike	4	45	55	100	C
	Ekonomiks ndërkombëtar	4	45	55	100	C
	Totali	29	345	380	725	

Viti III, Semestri II (6)						
Nr .	Modulet	Kredit e ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			Në Auditor	Studim individual/ Praktike Profesionale	Total	
Modul me Zgjedhje III						
1	Teknologjitë e përpunimit agroushqimor	5	60	65	125	C
	Vlerësim sensorial i ushqimeve dhe pijeve	5	60	65	125	C
Modul me Zgjedhje IV						
2	Menaxhim eventesh dhe atraksionesh rurale	5	60	65	125	B
	Menaxhim i burimeve natyrore	5	60	65	125	B
Modul me Zgjedhje V						
3	Gjeografia e turizmit, shtigjet dhe guidat	5	60	65	125	B
	Sistemet e menaxhimit të cilësisë në turizëm	5	60	65	125	B
Modul me Zgjedhje VI						
4	Shërbimi këshillimor	4	45	55	100	C
	Legjislacioni dhe siguria në turizëm	4	45	55	100	C
5	Praktike profesionale	6		150	150	D
6	Teza bachelor/ Provim përfundimtar	6	10	140	150	E
	Totali	31	295	605	900	